

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi , me procesmbajtësen Blerina Haziri, në lëndën penale kundër të pandehurve: M. S, B. R, B.P dhe K. D , për shkak të veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 253 , par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, sipas aktakuzës, PP.II.nr. 842/09 të dt. 16.07.2009, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit, Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 09.08.2017 shpalli publikisht, ndërsa më datë 15.08.2017 hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **M. S**, nga babai Q. dhe nëna B. e lindur A, i lindur më dt. ...në fsh., tani me vendbanim në Komuna e Gj , ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë , baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Të Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e, më dt. 31.03.2009, rreth orës 00-45-03.00 minuta , në Gjilan, në lagjen Dardania I, të pandehurit me qëllim që vetit ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror kanë kryer vjedhje në dëm të dëmtuarit A. M, në atë mënyrë që me forcë me ndihmën e një kaqavide hapin derën e lokalitit.., hyjnë brenda dhe nga aty marrin një TV plazma të markës intex me ngjyrë të zezë në vlerë prej 750 € dhe një llap top të markës Toshiba në vlerë prej 400 €.

Me çka ka kryer veprën penale , vjedhja e rëndë nga neni 253 par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së .

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve: 4, 41, 49 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK si dhe nenit dhe 365 të KPPK-ës, të pandehurit, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit **M. S.** , i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

Detyrohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata duke vepruar komfor nenit 358 par 1 dhe 2 nën par 1.3 të KPRK-së, ndaj të pandehurit B. P., e hudhë aktakuzën, PP.nr.842/2009 të dt.16.07.2009, sepse tani i pandehuri është i vdekur (i ndjerë) më dt. 10.10.2013, edhe atë sipas certifikatës së vdekjes me numër të referencës 4/2013RV/4001 të dt.27.10.2015 të lëshuar nga organi kompetent.

I dëmtuari A.M për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTH.DP në Gjilan , ka ngritur aktakuzën , PP.II.nr. 842/09 të dt. 16.07.2009 kundër të pandehurit M.S, me qka në bashkëveprim si bashkëekzekutorë kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1, nënparagrafi 1, lidhur me nenin 23 të KPPK-ës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe publik në të cilën ka prezantuar prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, i pandehuri Mentor Salihi, ndërsa i dëmtuari nuk ka prezantuar edhe pse i njëjti ka qen i ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës.

Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në diapozitivin e së njëjtës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj dënimin meritor në pajtim me Kodin Penal.

I pandehuri , pasi që u njoftua me aktakuzën përkatësisht veprën penale e cila i vihet në barrë, i njëjti deklaroi se e pranojë fajësinë komfor diapozitivit të aktakuzës.

Me që i pandehuri në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, vullnetarisht e pranojë fajësinë, gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për pranimin e fajësisë në pajtim me nenin 326 e në lidhje me nenin 248, të KPPRK-ës.

Gjykata duke u bazuar në nenin 36 të KPRK-së, veqoi procedurën penale për të pandehurin B. R dhe K. Dpër shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1, nën par 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, sipas aktakuzës PP.nr.842/2009 të dt.16.07.2009, e cila procedurë do të shqyrtohet dhe vendoset ndaras, duke marur numër të ri sipas regjistrimit penal të kësaj gjykate.

Meqenëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor i pandehuri e ka pranuar fajësinë shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, në fjalën përfundimtare deklaroi: duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe pas njoftimit të kësaj gjykate, lidhur me pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Me rastin e përcaktimit dhe llojit të dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

I pandehuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaron, e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale, duke i kërkuar falje te dëmtuarit, pendohem për të njëjtën, por e njoftoj gjykatën se kjo ka qenë hera e parë dhe e fundit që kam ra ndesh me ligjin, andaj kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Duke u bazuar në aktakuzën përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri si dhe pranimin e fajësisë nga i njëjti, gjykata vërtetoi se të i pandehuri qëndrojnë të gjitha elementet e kryerjes së veprës penale, vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së .

Me rastin e matjes se dënimit me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit, ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës, ku si rrethana lehtësuese ka marr për bazë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënimi me kusht, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe konsideron se edhe me këtë dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, si dhe ky dënim do të ndikoj te i pandehuri dhe personat potencial, ku jeton dhe vepron që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave tjera penale.

Shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nën par. 2.6 të KPRK-ës .

I dëmtuari, komfor nenit 463 të KPPK-ës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.49/13, Më 15.08.2017

Procesmbajtësja,
Blerina Haziri ,d.v.

Gjyqtari i vetëm gjykues
Islam Thaçi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore .